

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolejji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Shukri Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania “M.” me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson E. A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Republika e Kosovës-Ministria e Drejtësisë me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson N. A., sipas autorizimit për shkak të borxhit përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AE.nr.82/2015 datë 19.10.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.10.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.82/2015 datë 19.10.2015.

Aktgjykimi i cituar **ndryshohet** përkitazi me kamatën, dhe detyrohet e paditura që paditësit shumën e aprovuar t’ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të pa afatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, duke filluar nga data 18.4.2012, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.82/2015 datë 19.10.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.438/2014 datë 9.2.2015, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që paditësit në emër të dorëzimit të aparatit mjekësor C-ARM prodhim “S.” Gjermani t’ia paguajë shumën prej 49.250 €, me kamatë ligjore prej 3,5%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Me pjesën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.254 €.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar, duke i bartë edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kundërshtuar sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se palët ndërgjyqëse kanë qenë në marrëdhënie juridiko kontraktuese, në bazë të kontratës publike kornizë, për furnizim me material mjekësor, shpenzues dhe aparaturë mjekësore-ritender, me nr. identifikues ..., nr. i kontratës ..., ashtu që paditësi ka marrë për obligim që të paditurën ta furnizojë me aparat mjekësor C-ARM, të prodhuesit “Siemens”, Gjermani, ndërsa e paditura të paguajë çmimin prej 49.250 €. Paditësi e ka përmbushur objektin e kontratës ashtu që më datë 27.12.2011, të paditurës ia ka dorëzuar aparat, ndërsa e paditura ka refuzuar pranimin dhe montimin e të njëjtës, me arsyetim se ekziston dallimi i frekuencave të specifikacionit teknik nga 4.0 KW High Frekuency Generator, i kërkuar me tenderin e shpallur dhe ofertës së operatorit ekonomik-1.4 KW High Frekuency Generator, pas së cilës e paditura shkëput kontratën, ndërsa paditësi me padi kërkon përmbushjen e kontratës.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.138/2012 datë 11.06.2012, ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa në procedurën sipas ankesës, gjykata e shkallës së dytë, ka prish aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Në rigjykim pas vërtetimit të fakteve sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë dhe administrimit të provave, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar ankesën e paditësit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejt të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë, ndërsa nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimi i cekur në revizion se Gjykata e Apelit të Kosovës, me rastin e marrjes së vendimit ka bërë shkelje thelbësore nga neni 182 par. 2 pika (c) të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase gjyqtarja Fetije Sadiku në aktvendimin AE.nr.31/2013 datë 16.5.2014, ka qenë anëtare e kolegjit dhe në këtë rast nuk është vendosur për meritat e lëndës, por çështja është kthyer në rigjykim, e cila rrethanë nuk e përjashton gjyqtaren nga marrja e vendimit të çështjes në procedurën e mëvonshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi pretendimin e cekur në revizion se gjykata e shkallës së dytë ka tejkuluar kërkesëpadinë kur ka obliguar të paditurën për pagesën e shumës prej 49.250 €, por të njëjtën e vlerësoi si të pabazuar, ngase objekt i kontratës në mes ndërgjyqësve për paditësin ka qenë dorëzimi i aparatit mjekësor, ndërsa për të paditurën pagesa e shumës së cekur.

Thëniet e revizionit lidhur me karakteristikat e aparatit mjekësor, Gjykata Supreme e Kosovës, i shqyrtoi, por të njëjtat nuk patën ndikim për të vendosur ndryshe, ngase sipas kësaj Gjykate gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar nenin 32 të LMD, pasi që është vërtetuar se karakteristikat e motorit të aparatit mjekësor C-ARM nga 4.0 KW nuk janë precizuar në kontratën e lidhur në mes të palëve, përveç në dosjen e tenderit të shpallur. Me të drejtë gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar se në bazë të nenit të cekur oferta është propozim për lidhjen e kontratës, ndërsa në kontratë paraqiten të gjitha pjesët esenciale të çështjes. Kjo Gjykatë shton se ekspertët sipas komisionit të caktuar për dhënie të mendimit lidhur me aparaturën mjekësore kanë vlerësuar se aparati mjekësor i plotëson kërkesat e nevojshme për punë pa kufizime.

Nga fakti se kërkesat dhe detyrimet e palëve kontraktuese janë përcaktuar me kontratë, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë

kanë zbatuar të drejtën materiale kur kërkesëpadinë e paditësit e kanë vlerësuar si të bazuar, andaj edhe pretendimet e të paditurës se ligji material është zbatuar në mënyrë të gabuar janë vlerësuar si të pabazuara.

Pretendimin e revizionit se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë, Gjykata Supreme e Kosovës nuk e shqyrtoi, ngase në bazë të nenit 214 par. 2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike.

Lidhur me caktimin e kamatës aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, andaj si pasojë patën ndryshimin e tyre, ashtu që paditësit borxhi duhej t'i paguhet me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi një vit nga data 18.4.2012 e deri në pagesën definitive.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 222 lidhur me nenin 224 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr.33/2016, më 13.10.2016

Kryetare e kolegjit,

Emine Kaçiku